



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. Dep. DPK
Nr. Lepor. Nr. Lepor. Nr. Lepor.
Data Data Data
Nº. pages 03 03 03
PRISHTINA, 12.03.2020

03-03-794/20

PRISHTINA, 12.03.2020

DPK

PRISHTINA, 12.03.2020

DPK

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	13.03.2020
REFERENCË:	AKK- DPKPP /03-03-498/20
PËR/ZA/TO:	z. Gani LUTA, Menaxher i Prokurimit Kompania Regionale e Mbeturinave “Ambienti” SH.A Pejë
CC:	z. Nexhat ABDULLAHI. Kryeshef Ekzekutiv Kompania Regionale e Mbeturinave “Ambienti” SH.A Pejë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtësor i Agjencisë kundër Korruptionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtësor i Departamentit për Parandalimin e Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: “ Furnizim me kamion kompaktor të përdorur ”

Inderuar z. Luta

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, lidhur me tenderin me titull: “**Furnizim me kamion kompaktor të përdorur**”, me numër të prokurimit: KRM/20/569/121, dhe me nr. të brendshëm: Amb/20/20/121, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: “**Furnizim me kamion kompaktor të përdorur**”, me numër të prokurimit: KRM/20/569/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.



Arsyetimi

Agjencia kundër Korruptionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në sistemin elektronik të prokurimit, me datë 05 mars 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03/49820, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Furnizim me kamion kompaktor të përdorur**", me numër të prokurimit: KRM/20/569/121, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" SH.A.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike, të llojit furnizim, me vlerë të mesme të parashikuar **25,000.00 €**.

Agjencia, pasi ka analizuar dosjen e tenderit, konstaton se autoriteti kontraktues në specifikimin teknike ka kërkuar: **Kamion special për mbeturina-kompaktorë me peshë bartëse 3.4-4.0 (Tona)** i përdorur: **Fuqia e motorit 130-150 (KW)**, kërkesa këto për të cilat konsiderojmë se janë kufizuese.

Agjencia kundër korrupcion, konsideron se autoritetit kontraktues konkretisht njësia kërkuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpiloj specifikimet teknike në atë mënyrë që ato mos janë me vlera fiksë, por të caktohet minimumi i kërkeseve teknike, dhe që të janë të hapura për të gjithë operatoret ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizime të tilla. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Në paragrafin 1 në mënyrë decidive thuhet se "Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Paragrafi 2 parasheh se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik".

Paragrafi 3 "pa e cenuar paragrafin e mësipërm, Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përbledh sasitë ose artikujt e tjera që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkësë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik".



ROTIVKO
+ RPK

Në paragrafin 4 parashihet se "Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik".

Pas analizimit të njostimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia ka vërejtur se autoriteti kontraktues si kriteri për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kriteri i ka caktuar: 1. Çmimi të cilin i ka caktuar koeficientin prej 0,60%, nën kriteri 2. Viti i Prodhimit koeficientin prej 0,15%, nën kriteri 3. Kilometrazhi i kaluar me koeficient 0,15%, dhe nën kriteri 4. Afati i liferimit me koeficient 0,10%.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës nr. 2. "Viti i Prodhimit koeficientin prej 0,15%", nr.3. "Kilometrazhi i kaluar me koeficient 0,15%", dhe nën kriterit nr. 4. "Afati i liferimit me koeficient 0,10%.", nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, përfaktin se në nenin 28 paragrafi 3 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, specifikohen qartë cilat, kriteri mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm. Ndërsa, sa i përket nën kriterit nr. 4. "Afati i liferimit me koeficient 0,10%.", Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues mund të caktoj afatin kohor përfurnizim ne Kushtet e veçanta të kontratës, konform nenit 19.3.

Agjenci kundër Korrupsion, rekomandon autoritetin kontraktues që në rast se specifikon në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, kriterin për dhënie të kontratës tenderin ekonomikisht më te favorshëm, duhet të këtë kujdes që të caktoj nën kriteri të qarta, precise dhe të cilat janë kriteri të matshme, komform natyrës së aktivitetit të prokurimit.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7, nenin 27, 28 nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënen e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenin 20 dhe nenin 28 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njostimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njofuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njostojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!